



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	03.11.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Xhelal HALILOSMANI U.D. Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Gjakovës
CC:	z. Mimoza KUSARI - LILA Kryetare e Komunës së Gjakovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Punimi i Planit Rregullues urban të hollësishëm të zonës nga rruga "Nëna Terezë", "Fehmi Agani", "Sadik Stavileci" deri te rruga "Tivar"

I nderuari z. Halilosmani ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me "Punimi i Planit Rregullues urban të hollësishëm të zonës nga rruga "Nëna Terezë", "Fehmi Agani", "Sadik Stavileci" deri te rruga "Tivar" me numër prokurimi: 632-14-065-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull " Punimi i Planit Rregullues urban të hollësishëm të zonës nga rruga "Nëna Terezë", "Fehmi Agani", "Sadik Stavileci" deri te rruga "Tivar" me numër prokurimi: 632-14-065-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsy etimi

Komuna e Gjakovës, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me "Punimi i planit rregullues urban të hollësishëm të zonës nga rruga "Nëna Terezë","Fehmi Agani","Sadik Stavileci" deri te rruga "Tivar " , me numër prokurimi: 632-14-065-221 i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.23.10.2014 në Procedurën e Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në fushën e Prokurimit Publik (DPKPP) pranë, Agjencisë kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, AKK ka hasur në disa dhëna të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës. Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e ofruar nga ana e Autoritetit kontraktues ka konstatuar faktet si në vijim:

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, Agjencia ka vërejtur se si kriter për dhënie të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka caktuar kriterin *Tenderi ekonomikisht më i favorshëm*, ndërsa si nën kritere i ka vendosur **1.** Çmimin të cilin e ka peshuar me 50 %, **2.** Planin dinamik të punëve ku ka kërkuar dëshmi me shkrim nga Operatori Ekonomik për afatin e kryerjes së punimeve të cilit i ka caktuar peshë prej 15 %, **3.** Referencat për punët e kryera dhe të vlerësuara nga fusha e planifikimit hapësinor ku ka kërkuar të paraqitet lista e projekteve të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit(2011,2012,2013) e vërtetuara nga Operatori Ekonomik ku përfshihen titujt e projekteve të cilin e ka peshuar me 20 %, **4.** Stafi- përgatitja profesionale e stafit ku ka kërkuar Minimum 2 inxhinier të diplomuar të arkitekturës apo master me përvojë pune në fushën përkatëse(arkitekturës dhe planifikimit urban), minimum 1 inxhinier të ndërtimit apo master me përvojë pune në fushën përkatëse, minimum 1 inxhinier të hidros apo master me përvojë pune në fushën përkatëse, minimum 1 Gjeometër me përvojë pune në fushën përkatëse dhe minimum 1 ekspert me përvojë pune në fushën e mjedisit të cilin e ka peshuar me 15 %

Lidhur me nën kriteret 2,3 dhe 4 Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se nën kritere të tilla nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si kritere për dhënie të kontratës nga ana e Autoritetit kontraktues.

Autoriteti kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve për dhënie të kontratës, sipas nenit 23 paragrafi 5 dhe nenit 25 paragrafi 3 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si kritere për dhënie të kontratës, andaj konsiderojmë se nën kriteret e vendosura si më lartë nuk janë kritere të matshme dhe do duhej të caktoheshin si kritere minimale për kualifikim.

Gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit, Agjencia ka vërejtur se Njësia e Kërkesës i ka propozuar gjithashtu edhe kriteret e përzgjedhjes e që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, ku përcaktohen qartë funksionet e

njesisë kërkuese dhe njesisë së prokurimit, andaj secila duhet veproj konform përgjegjësive që ka.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin nenin **52** Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin **23** Kriteret e përzgjedhjes e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe nenin **25** Kriteret e dhënies së kontratës e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

